REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 99/17
Datë/Datum. 06.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Kuvendi Komunal Prizren**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-17-302-221**

Sa i përket tenderit për: **Sigurimi fizik i objekteve shëndetësore**

A N K E S Ë

1. IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK

GRUPI: **"COMMANDO" SH.P.K & "SECURITY CODE" SH.P.K**
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.JONI P.NR
(Adresa)

PRIZREN — *(Vendi)*

20 000 — *(Kodi postar)*

045 99 16 16 — *(Numri Telefonit)*

(Numri i Faks-it)

BESIM SHKURTI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@commando.name
(Adresa elektronike)

06.04.2017
(Data e parashtrimit të kërkesës)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR COMMANDO PRIZREN LIMITED LIABILITY COMPANY

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. IDENTIFIKIMI I AVOKATIT

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. TË DHËNAT MBI AKTIVITETIN E PROKURIMIT

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratë (**23.02.2017**) – E-Prokurim
- Oferta e përgjegjshme, **çmimi më i ulët**
- Hapja e ofertave: **14.03.2017** ora: **14:00**
- Njoftimi për dhënie të kontratës (**27.03.2017**) - KRPP

4. PROCESI I HAPJES SË TENDERËVE, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Gjatë hapjes së ofertave, komisioni i hapjes ka hapë ofertat e dorëzuara, dhe procedura gjithçka ka qenë në rregull.

5. NJOFTIMI MBI ELIMINIMIN E TENDERUESËVE, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [ ] **Jo** [X]

Jemi njoftuar vetëm përmes platformës elektronike, për tenderuesin e pasuksesshëm.

6. ZGJIDHJA PRELIMINARE E MOSMARRËVESHJEVE

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues përkundër kërkesës sonë për ri-shqyrtim merr vendim për refuzim të ankesës si të **pabazuar**, si dhe hedh poshtë të gjitha pretendimet tona ankimore.

Autoriteti Kontraktues në momentin e pranimit të kërkesës për ri-shqyrtim është dashur ta bëjë **pezullimin e aktivitetit të prokurimit** sipas par.2 të Nenit 108/A të LPP-së, dhe ti informoj të gjithë Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, gjë që nuk e ka rrespektuar këtë dispozitë duke bërë shkelje.

Autoriteti Kontraktues është dashur që të përgjigjet për secilën pikë të ankesës, e jo të përgjigjet në pika të shkurta sipas dëshirës, duke i anashkaluar pretendimet tjera ankimore në mënyrë profesionale.

Me një fjalë ju AK ka vepruar edhe në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-së duke vepruar në mënyrë diskriminuese dhe duke ia mohuar të drejtën Operatorëve Ekonomik pjesëmarrjen në Grup duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë pasi që ka vendosur kërkesë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së.

7. DISPOZITAT E SHKELURA NGA AUTORITETI KONTRAKTUES

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues supozohet se ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së duke filluar që nga Njoftimi për Kontratë e deri në Njoftimin mbi Dhënien e Kontratës.

Dispozitat e LPP-së të supozuara se janë shkelur:

- Neni 7 i LPP-së
- Neni 55 i LPP-së
- Neni 59 i LPP-së
- Neni 72 i LPP-së
- Neni 108/A i LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. DEKLARATË DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datën 24.03.2017 kemi pranuar në llogarin e kompanisë sonë në platformën elektronike (E-prokurim) njoftimin nga ana e Autoritetit Kontraktues letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

PROVË: Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm

Menjëher pas pranimit të kësaj shkrese me datën 24.03.2017 kompania jonë ka kërkuar qasje në dokumentet e tenderit sipas Nenit 10 par.3 të LPP-së

PROVË: Kërkesa / Qasje në Dokumente

Po të njejtën datë me 24.03.2017 kemi pranuar përgjigje nga ana e AK-së në lidhje me lejimin në qasje të dokumenteve për me datën 27.03.2017 në ora 10:00.

PROVË: Përgjigje nga Autoriteti Kontraktues

Pas qasjes që ka pasur kompania jonë në dokumentet e këtij aktiviteti të prokurimit me datën 27.03.2017 ka marr dokumente të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës dhe OE e listuar në vendin e dytë për nga çmimi.

PROVË: Dokumentet e kompanisë "SFK" SH.P.K (OE i rekomanduar për dhënie të kontratës) dhe "ROSA - SECURITY" SH.P.K (OE e listuar e dyta me rradhë).

Me datën 28.03.2017 kompania jonë ka bërë në mënyrë elektronike "Kërkesë për Rishqyrtim" pranë Autoritetit Kontraktues.

PROVË: Kërkesa për Rishqyrtim e datës 28.03.2017

Me datën 30.03.2017 Autoriteti Kontraktues ka kthyer përgjigje duke konfirmuar se kërkesa është pranuar dhe është proceduar, si dhe ka kërkuar nga kompania jonë një afat shtesë duke iu referuar pikës 6 të Nenit 108/A të LPP-së pasi që sipas tyre kanë kërkuar interpretim ligjor në KRPP për disa çështje.

PROVË: Përgjigje nga Autoriteti Kontraktues të datës 30.03.2017.

Po të njejtën datë me 30.03.2017 kompania jonë ka reaguar fillimisht duke e njoftuar Autoritetin Kontraktues se duhet të pezulloj aktivitetin e prokurimit dhe se është duke vepruar kundër dispozitave ligjore përkatësisht pikës 2 të Nenit 108/A të LPP-së, pasi që edhe pse kanë pranuar se është pranuar kërkesa për rishqyrtim nuk është pezulluar ky aktivitet i prokurimit siç kërkohet me ligj.

PROVË: Përgjigje e kompanisë sonë e datës 30.03.2017 drejtuar AK

Gjatë analizimit të dokumenteve të rekomanduar për dhënie të kontratës ne kemi hasur në disa parregullësi tek dokumentacioni i kompanisë "SFK" SH.P.K si:
Ky OE ka vendosur një Certifikatë të biznesit së bashku me informatat mbi biznesin, në këtë Certifikatë shihen informatat si Nr.Biznesit dhe Nr.Fiskal, pasi që tek bizneset që janë regjistruar pas vitit 2014 Nr.Fiskal shënohet në Certifikatën e Biznesit.

Ky OE ka vendosur edhe një Certifikatë të Nr.Fiskal të të njejtit biznes i cili daton "para regjistrimit të kompanisë" pra e vitit 2009 e cila duket e falsifikuar pasi që ne e kemi vërtetuar nga ATK që nuk mund të jepen dokumente para se të regjistrohet një biznes në ARBK (Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë).

PROVË: Certifikata e Biznesit të OE të rekomanduar për kontratë "SFK" SH.P.K dhe Certifikata e Nr.Fiskal e vitit 2009.

Poashtu e kemi njoftuar AK në kërkesën për Rishqyrtim se ky OE "SFK" SH.P.K ka përdorur disa dokumente të një subjekti tjetër me emër të ngjashëm, dokumente të cilat nuk i ka plotësuar vetë dhe është munduar ta lajthit Autoritetin Kontraktues.

Në qasjen e dokumenteve kemi marrur edhe si provë disa dokumente të tjera sepse AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit ka kërkuar që tek "Kërkesat mbi Gjendjen Ekonomike dhe Financiare" që:

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **Kërkesa 1** **Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2014-2015-2016) ka qenë gjithsej jo më pak se 90.000.00 Euro.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1** **Pasqyrat financiare të kompanisë,të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e fundit (2014-2015-2016) apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.**

OE i rekomanduar për kontratë **"SFK" SH.P.K** siç e cekëm më lartë ka përdorur dokumente të subjektit tjetër me emër të ngjashëm N.T.SH "SFK" e i cili biznes sipas informatave që i kemi marr ONLINE në web-faqen e ARBK-së (http://arbk.rks-gov.net) figurojnë si biznese të ndryshme me status të ndryshëm.

PROVË: Pyetje dhe Përgjigje nga Drejtori i ARBK-së, sqarimi i dhënë për këto dy biznese

PROVË: Dokument nga web-faqja e ARBK-së

Pra OE **"SFK" SH.P.K** për ta plotësuar kërkesën e AK-së në lidhje me Gjendjen Ekonomike dhe Financiare, përsëri është munduar ta lajthit AK-në duke vendosur disa Vërtetime Bankare dhe një Pasqyrë Bankare dhe disa dokumente të subjektit tjetër N.T.SH "SFK" të Administratës Tatimore të Kosovës, me çrast ka rënë edhe në kundërshtim me Deklaratën Nën Betim.

PROVË: Dokumentet si në vijim:

1. **Vërtetim i Qarkullimit** nga ProCredit Bank të subjektit N.T.SH "SFK" (subjektit me të cilën nuk ka ofertuar), vërtetim i datës 15.12.2015
2. **Confirmation Letter** nga TEB Banka të subjektit N.T.SH "SFK" (subjektit me të cilën nuk ka ofertuar), vërtetim i datës 15.12.2015
3. **Vërtetim i Qarkullimit** nga ProCredit Bank të subjektit "SFK" SH.P.K (subjektit me të cilën ka ofertuar), vërtetim i datës 13.02.2017

4. **Pagyra Financiare** nga ProCredit Bank e subjektit "SFK" SH.P.K (subjektit me të cilën ka ofertuar), pasqyra është e datës 11.02.2017 e dokumentuar me 23 faqe e që gjendja e përgjithshme në këtë pasqyrë figuron 26,832.73 € qarkullim.

Kurse Autoriteti Kontraktues ka kërkuar nga OE-të që Kërkesën për Gjendjen Ekonomike dhe Financiare ta dokumentojnë për tri (3) vitet e fundit 2014-2016 me anë të Pasqyrave Financiare apo Deklaratave Tatimore Vjetore të ATK-së se qarkullimi është jo më pak se 90,000 EURO.

OE "SFK" SH.P.K i rekomanduar për kontratë në bazë të dokumentit të besueshëm që e ka ofruar **Pasqyrën Financiare** nuk e mbulon kërkesën prej 90,000 EURO pasi që me vetë dokumentin e tij ka ofruar vetëm 26,832.73 EURO.

5. OE "SFK" SH.P.K përsëri është munduar ta lajthit Autoritetin Kontraktues duke vendosur në ofertën e tij dokumente si:

* Formulari i Deklarimit Vjetor dhe Pagesës për Tatimin në të Ardhura Personale për Periudhën e Deklarimit të Vitit 2015 i cili formular përmban numër fiskal 600083646 e cila poashtu figuron e subjektit tjetër N.T.SH "SFK".
* Rivlerësim për Tatim në të Ardhura Individuale N.T.SH "SFK" me nr.fiskal **(FIN) 600083646** të datës 28.03.2014.
* Rivlerësim për Tatim në të Ardhura Individuale N.T.SH "SFK" me nr.fiskal **(FIN) 600083646** të datës 13.04.2015.

Pra edhe këto dokumente të ofruara të ATK-së nuk janë të subjektit me të cilin ka aplikuar OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "SFK" SH.P.K.

Për më shumë detaje ju rekomandojmë ta lexoni "KËKESËN TONË PËR RISHQYRTIM".

Poashtu OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka arritur ta plotësoj kushtin tjetër/ kërkesën në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit se:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kërkes 1.** **Projektet te ngjashme te realizuara ne tri vitet e fundit (2014, 2015 dhe 2016), e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlera, minimumi te jetë 65.000.00 €** **Kërkesa 2** **OE duhet të prezantojë listën e stafit profesional i cili do të mbulojë realizimin e kontratës.**	*Dështmia e kërkuar dokumentare* **Dështmia 1** **Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, kurse kopje për dosien në kopje fizike, të deshmuara me referenca apo pranimi përfundimtar i shërbimeve – (kopje).** **Lista e stafit me të gjitha t[ë dhënat mbi përvojën dhe pregaditjen profesionale të stafit**

Andaj duke u bazuar në kërkesën e Autoritetit Kontraktues OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "SFK" SH.P.K e cila përmban numrin fiskal **601261522** në të njejtën mënyrë është munduar ta lajthit Autoritetin Kontraktues duke vendosur dokumente si:

PROVË:

1. Lista e Pagave për kompaninë e lëshuar nga ATK me datën 26.08.2015 me emër të kompanisë (subjektit tjetër) N.T.SH "SFK" me nr.fiskal **600083646**.
2. Lista e Furnizimeve të Realizuara në Tri vitet e fundit 2013, 2014, 2015 e cila është në emër të subjektit "SFK" SH.P.K.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar **"listën e stafit"** me të gjitha të dhënat mbi përvojën dhe pregaditjen profesionale të stafit.

OE i rekomanduar për kontratë pos që nuk ka ofruar "LISTËN E STAFIT" është munduar që me anë të listës së pagave të subjektit tjetër ta mbuloj këtë kërkesë, e kjo është në kundërshtim me kërkesën pasi që është Kërkuar një Listë e Stafit e jo Listë të Pagave, pra edhe kjo listë e pagave i përket subjektit tjetër.

Pra sa i përket dokumentit të OE të rekomanduar për kontratë "SFK" SH.P.K të titulluar si "LISTA E FURNIZIMEVE TË REALIZUARA NË TRI VITET E FUNDIT 2013, 2014, 2015" është poashtu kërkesë e pa plotësuar pasi që ky aktivitet i prokurimit është SHËRBIM dhe jo FURNIZIM, poashtu AK ka kërkuar që të dokumentojnë OE-të Listën e Projekteve për vitet 2014, 2015, 2016) dhe jo për vitet (2013, 2014, 2015) ashtu siç e ka vendosur OE fitues.

Lista e OE "SFK" SH.P.K që është në formën tabelare shihet se të gjitha kontratat e cekura në tabelë janë AKTIVE dhe të pa përfunduara, kërkesa është të dëshmohen me raport përfundimtar apo referenca, për kontratat e cekura në listë, gjë që ky OE nuk ka arritur të dëshmoj.

Për më shumë detaje ju rekomandojmë ta lexoni "KËKESËN TONË PËR RISHQYRTIM".

Pra OE i rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme pasi që nuk i plotëson kërkesat e cekura në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

* * * *

Ne kemi vërejtur që këto dy biznese janë biznese familjare duke iu referuar mbiemrit që posedojnë të të katërtat (4) biznese që janë përfshirë në këtë tender, dhe që luajnë këso lojërash duke i lajthitur Autoritetet Kontraktuese.

Për më shumë detaje ju rekomandojmë ta lexoni "KËKESËN TONË PËR RISHQYRTIM".

Kjo kompani "ROSA – SECURITY" SH.P.K me numër fiskal **601255377** nuk ka plotësuar kërkesat mbi Gjendjen Ekonomike dhe Financiare pasi që nuk ka dëshmuar përmes "PASQYRËS FINANCIARE" apo "DEKLARATAVE VJETORE TATIMORE TË ATK-SË" mirëpo ka përdorur si dokumente vetëm Vërtetime Bankare nga ProCredit Bank dhe TEB Bank të subjektit tjetër të ngjashëm e i cili biznes përmban numër tjetër fiskal **600430128** , N.T.SH "ROSA SEKURITY".

Pra Autoriteti Kontraktues ka kërkuar dëshmi të dokumentuar si: "**PASQYRËS FINANCIARE**" apo "**DEKLARATAVE VJETORE TATIMORE TË ATK-SË**" dhe jo VËRTETIME BANKARE.

Poashtu OE i listuar me rradhë si e dyta "ROSA - SECURITY" SH.P.K nuk e plotëson kërkesën tjetër për kapacitetin teknik dhe profesional pasi që edhe këtu ka përdorur kontrata dhe referenca të subjektit tjetër N.T.SH "ROSA SEKURITY" e që është biznes tjetër dhe dallon për nga forma sepse ky i fundit figuron në sistemin online të ARBK (Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve) pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si **BIZNES INDIVIDUAL.**

Pra pos që ka lajthitur Autoritetin Kontraktues në lidhje me listën që e ka ofruar si Listë e Furnizimeve, në listë poashtu figurojnë kontrata aktive të pa përfunduara dhe nuk mund të lëshohen referenca apo raporte të pranimit përfundimtar të shërbimeve, ky OE ka vetën dy kontrata sipas listës të përfunduara, kontrata e listuar me nr.rendor 1 kap shumën prek 9,800 EURO dhe kontrata me nr.rendor 3 kap shumën prej 9,500 EURO e që në total të përfunduara janë vetëm 19,300 EURO kurse kërkesa e Autoritetit Kontraktues është të dëshmohet vlera minimum 65,000 EURO.

Ju ishim lutur që ta lexoni edhe **"Kërkesën tonë për Rishqyrtim drejtuar Autoritetit Kontraktues"** pasi që aty ka shumë informacione dhe detaje të tjera që ndoshta mund ti kem harrur për ti shënuar në këtë ankesë.

Supozojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e Nenit 59 dhe Neni 72 par.3 të LPP-së pasi që dyshohet se mund të ketë kërkuar informata shtesë dhe mund të ketë pranuar dokumente shtesë të cilat gjatë qasjes publike në dokumentet e këtij aktiviteti të prokurimit i kanë munguar OE të rekomanduar për dhënie të kontratës e që kjo është e ndaluar me ligj që pas përfundimit të procedurës të bëhet diçka e tillë.

KUJDES: Të kërkohen të gjitha komunikimet që janë bërë në mes të AK dhe OE të rekomanduar për kontratë pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, si dhe çdo dokument shtesë që është paraqitur pas datës 14.03.2017 (ditë së hapjes së ofertave) ti analizohet data e dokumenteve.

Autoriteti Kontraktues **KOMUNA PRIZREN** duke i shikuar se të gjitha shkresat tona janë me vend, ka refuzuar ankesën tonë duke u bazuar mesiguri në dokumente apo prova të ndryshme që nuk është dashur ti merr në konsideratë, pasi që është dashur ti drejtohet organit **të vetëm** kompetent për Bizneset në Kosovë (ARBK-së) dhe se gjatë qasjes zyrtari i prokurimit bazohet se këto biznese janë i njejti biznes i ndryshuar sipas ligjit, mirëpo ne kemi vërtetuar këto biznese dhe nuk i janë nënshtruar procedurave për ndryshimin e formës së biznesit sipas Vendimit Publik Shpjegues 02/2016 të ATK-së.

PROVË: Përgjigje nga Drejtori i ARBK-së (Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve)

PROVË: Vendimi Publik Shpjegues 02/2016 – ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)

Në certifikatat e OE të rekomanduar për kontratë "SFK" SH.P.K *dhe* "ROSA – SECURITY" SH.P.K si e dyta me rradhë nuk kanë asnjë informatë të nr.të biznesit të vjetër dhe nr.fiskal të vjetër.

PROVË: Certifikata e Biznesit e cila përmban informatat e vjetra dhe të reja në rast të ndryshimit të formës së Biznesit.

Pra edhe në sistemin online të ARBK-së (http://arbk.rks-gov.net) këto biznese me bizneset tjera po dallojnë nga forma dhe shihen si aktive pra nuk janë biznese të njejta.

Ju mund ti verifikoni tek ARBK si organ kompetent i vetëm për bizneset në Republikën e Kosovës e poashtu mund ti verifikoni edhe në ATK këto biznese.

Andaj duke u bazuar në të cekurat më lartë kërkojmë nga OSHP që ankesën tonë për ta aprovoj të bazuar dhe lëndën njëherit ta kthej në ri-vlerësim.

9. DËMET MATERIALE

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Autoriteti Kontraktues pos që kompanisë sonë do ti shkaktoj dëme të konsiderueshme material duke na humbur një kontratë me vlerë të mesme, duke ia dhënë kontratën një Operatori Ekononik që ka çmim më të shtrenjt.

10. LISTA E DOKUMENTEVE (DËSHMIVE) TË BASHKANGJITURA

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*